



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA E KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRAN	
01 Nr. / Br	132 / 19
Nr. i lq. / Dr. st	- 17 -
Data / Datum	25.04.2019
VUSHTRRI - VUČITRAN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCES VERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E -III- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË**  
**VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 28 MARS 2019**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:20.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:

Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Gresa Muli, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Qerim Selimi, Rrezarta Krasniqi, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Shkëlzen Feka, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

**Mungoi: Shpëtim Zhegrova.**

*Lutfi Bilalli dhe Sami Istrefi, anëtarë të kuvendit që janë dorëhequr nga pozita e anëtarit të kuvendit, por procedura e zëvendësimit të këtyre pozitave nga ana e KQZ-së akoma nuk ka përfunduar.*

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkryetari i komunës Besim Muzaqi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë prezent 32 anëtarë të kuvendit, shumicë kjo e mjaftueshme për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - deklaroi se keqpërdorimi i automjeteve zyrtare është vazhduar, andaj kërkoi nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që të menaxhojë dhe të raportojë në kuvend shfrytëzimin e automjeteve të cilat duhet të jenë në autoparkun e komunës, ku nuk kanë të drejtë shfrytëzimin e automjetit zyrtar njëzet e katër orë (24 h) përpos kryetarit të komunës. Gjithashtu theksoi se kryetari duhet t'i tërhiq këto autorizime sepse janë në kundërshtim me ligjin dhe duke e keqpërdor taksën e qytetarëve. Andaj përsëriti dhe bëri të ditur për kuvendin se të shfrytëzimi i këtyre automjeteve është në kundërshtim me ligjin dhe rregulloren në fuqi dhe në këtë kontekst kërkoi nga kryetari i komunës dhe drejtoria gjegjëse që të ndalet kjo praktikë e keqpërdorimit të detyrës zyrtare sa i përket shfrytëzimit të aseteve të komunës.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - tha se ka ardhur koha ta kuptojmë njëherë e mirë se kuvendi komunal është degë ligjvënëse në komunë, si dhe ka përgjegjësinë e mbikëqyrjes së organeve ekzekutive, kryetarit dhe administratës komunale. Funksionimi ligjor dhe efektiv i kuvendit komunal si instrument mbikëqyrës kërkon përputhshmëri me kornizën relevante procedurale dhe rregullative, ashtu siç përcaktohet në veçanti me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Përveç këtyre, Ligji për Vetëqeverisje Lokale parasheh që kuvendi komunal luan rol thelbësor në vendimmarrje mbi çështjet e rëndësishme komunale. Prandaj: Ky ligj, themelon bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale. Kuvendi i Komunës është organi më i lartë i komunës që përbëhet prej anëtarëve të tij të zgjedhur. Kryetari është organi më i lartë ekzekutiv i komunës që zgjidhet përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta. Me siguri që po, por mos vallë e ka harruar ai betimin e dhënë? Të nderuar anëtarë të kuvendit, Ligji për Vetëqeverisje Lokale parasheh edhe përgjegjësitë e kryetarit, dhe në pikën “d” të nenit 58 të ligjit në fjalë, kryetari obligohet t’i ekzekutojë vendimet e kuvendit komunal. Kryetari ynë, në raste të caktuara po reflekton me arrogancë dhe shenja të krizës në qeverisje, një shembull tipik i shfaqur para anëtarëve të kuvendit (për të cilët nuk kishte aspak respekt) në mbledhjen e fundit, është rasti i votimit të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale. Në momentin që ai e vërejti se, vendimi i anëtarëve të kuvendit nuk është ai që kryetari e dëshironte, apo thënë ndryshe ai “Koalicioni me shumë të panjohura” siç e kam quajtur më herët, një ditë do të del në pah, pra nuk mundi ta përdor arrogancën e numrave, kuvendit iu drejtua me këto fjalë: Po citoj: *“Zotohem para kuvendit dhe para qytetarëve, se si qeveri e komunës nuk e kam ndërmend që ta hedhi në ankand publik asnjëherë nga këto prona për afat të shfrytëzimit për 99 vite.”* Nëse kryetari këtë e ka thënë në shenjë revolte edhe mund ta kuptoj, por nëse me të vërtetë edhe sot mendon njëjtë, atëherë pyetja shtrohet: Çfarë kuptimi kanë aktet komunale të cilat i voton Kuvendi Komunal si organi më i lartë i komunës që përbëhet nga 35 anëtarë të zgjedhur? Prandaj, edhe pse kryetari e solli në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2018, në shqyrtim një akt komunal (ende pa hyrë në fuqi), i cili nuk cenonte legjislacionin në zbatim, por ndoshta e cenonte interesin e individëve partiak, ai nuk arriti t’i bindte shumicën e anëtarëve të kuvendit të votojnë sipas dëshirës së tij. Shpresoj që kryetari të reflektojë, të ketë më shumë konsideratë për anëtarët e kuvendit, për shërbyesit civil e mbi të gjitha për qytetarët që ia besuan këtë mandat, sepse në praktikën qeverisëse është dëshmuar se cilido pushtet që në qeverisje ka shfaqur arrogancë ka qenë i destinuar për humbje. Dhe krejt në fund, të nderuar anëtarë të kuvendit iu bëj thirrje: Ta mbajmë përgjegjës kryesuesin e kuvendit si mbrojtës efektiv i procedurave, i cili duhet të jetë më proaktiv në mbrojtjen e rolit të kuvendit, si organ mbikëqyrës legjislativ vizavi ekzekutivit komunal.

**Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit** – paraqiti vërejtje për kryetarin e komunës që po trajton komunën si pronë private. Ceku rastin në Drejtorinë e Arsimit që është punësuar një qytetare nga Kamenica e që është një e afërt e kryetarit të degës së LDK-ës në Kamenicë Shaip Surdullit. Po ashtu ceku edhe për përkrahjen ndaj Mexhit Përçukut për t’u zgjedhur anëtar i bordit në “ Ibër – Lepenc”, ku tha se kryetari funksionon vetëm për vete dhe se bizneset dhe qytetarët i shikon vetëm si plaçkë. Në fund tha se nëse Sedat Rashica është shkarkuar për arsye të mosmenaxhimit dhe mosefikasitetit në punë është dashur që edhe të tjerë të shkarkohen. Në këtë relacion shihet qartë se kryetari aktual sillet si një sundimtar primitiv karshi pronës komunale dhe qytetarëve. Mandej vuri në dukje ashtu që të vetëquajturit komunitet që nuk nënshtrohet, duke aluduar në Lëvizjen Vetëvendosje në rastin konkret mund të thuhet se i janë nënshtuar plotësisht kryetarit aktual të komunës.

**Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit** – propozoi që të ndahet një fond i veçantë për t’i ndihmuar personave me trajtim mjekësor me sëmundje të kancerit. Krijimi i këtij fondi do t’i jep

mundësi të ketë qasje secili që ka nevojë sepse kostoja e shërimit të kësaj sëmundjeje është shumë e lartë dhe përmes këtij fondi do t'ju lehtësohet sado pak nga ana financiare.

**Fatmire Saraçi, anëtare e kuvendit** – paraqiti kërkesën e kryetarit Feriz Sadiku të fshatit Gllavatin, për një përkrahje financiare për banorin e fshatit Hakif Krasniqit ku si pasojë e një fatkeqësie ka pësuar nga zjarri me një dëm rreth 6.000 euro dhe shtoi se çdo ndihmë për të do të ishte e mirë sepse gjendjen ekonomike e ka të rënduar. Kërkoj që kjo kërkesë të futet në rend të ditës.

**Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit** – tha se në fshatin Maxhunaj nuk ka asnjë ndryshim që një vit e gjysmë, deklaroi se shportat e mbeturinave nuk janë dërguar edhe pse bëjnë pagesën, por janë dërguar në fshatin Stanoc. Po ashtu është bërë kërkesa për ndriçimin e rrugëve, por nuk pati efekt kërkesa, kurse në fshatin Vërnice janë vendosur ndriçuesit. Megjithatë kërkoi që të marrin më me seriozitet të dy kërkesat për fshatin Maxhunaj.

**Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit** – parashtrroi kërkesë për informatë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike për fshatin Bukosh, a do të bëhet ndërtimi i trotuarit nga shkolla e Bukoshit e më lartë, për shkak se mungesa e saj po sjell aksidente e që ka pasur raste me fatalitet.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit** - theksoi se kuvendi është përgjegjës që të përcjellë kërkesat e anëtarëve të kuvendit dhe të njëjtat do t'i adresojë me shkrim edhe në drejtoritë përkatëse. Gjithashtu përmendi edhe kërkesën specifike të znj. Fatmire Saraçit dhe ka kërkuar nga Drejtori për Buxhet dhe Financa zt. Lutfi Gërguri një sqarim, i cili tha se së pari duhet që komisioni të vlerësojë situatën, dëmet dhe të paraqet vlerësimet për shumën dhe vendimin konform mundësisë buxhetore.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** - tha se anëtarja e kuvendit komunal ka paraqitur kërkesën në kuvend dhe se është detyrë që kryetari ta obligojë komisionin që të dalë për vlerësim dhe se anëtarja nuk ka nevojë që të dorëzojë kërkesa tjera në drejtoritë përkatëse.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** – theksoi se çdo anëtar i kuvendit ka autoritetin të jep propozime që të futen pika shtesë në rendin e ditës dhe se kuvendi ka autoritetin që me shumicë të votave të merr vendim dhe në rast aprovimi, kuvendi ka të drejtë të aprovojë vlerën, duke mos ndërhyrë me komisione pasi që sipas tij është kompetencë e kuvendit.

**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit** – parashtrroi ankesë, pasi që nuk po bëhet bartja e mbeturinave, ndërsa kishte paguar nga muaji korrik i vitit 2018.

**Bahrije Ademi - Murati, anëtare e kuvendit** – parashtrroi kërkesë në emër të banorëve të fshatit Studime që të shpalojë kërkesat e banorëve të këtij fshati, për trotuar, rrjetin e ujërave të zeza, për drita dhe kërkesa tjera. Gjithashtu tha se fshati Studime është anashkaluar edhe duke u ditur kontributi i këtij fshati për lirinë e vendit.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit** – duke i' u kthyer pikave të rendit të ditës tha se pika numër 6 “ Shqyrtimi i propozim- vendimit për themelimin e Komitetit për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së“ është larguar, si rezultat i një udhëzimi të ri administrativ dhe i një takimi që është zhvilluar me shoqëritë e dala nga lufta. Në vazhdim ai prezantoi pikat shtesë për futje në rend të ditës.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** - kërkoi që në rendin e ditës të futet në rishqyrtim pika 1.2 e vendimit Nr.22/18 që lidhet me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, konkretisht parcela kadastrale P-7020216-02356-1 ku në mbledhjen e janarit kjo është dhënë në shfrytëzim për 99 vite përmes një konkursi publik personave fizikë dhe juridikë për ndërtim të lartë. Por, komuna nuk ka asnjë interes që të jepet kjo parcelë për ndërtim të lartë. Prandaj kërkoi që kjo çështje të futet në rend dite dhe që kjo pronë t'i mbetet komunës. Arsyetim dha se kjo pronë bën pjesë në shumë prona të tjera të vjetra të komunës dhe se grupi parlamentar i LDK-së është kundër që dikush të përfitojë privatisht dhe se kjo pronë duhet t'i kthehet komunës.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** – kërkoi që menjëherë pas kërkesave të anëtarëve të hedhen në votim, nëse duhet të futen në rend të ditës dhe se secila pikë që propozohet nga anëtarët e kuvendit duhet të hedhet në votim. Mandej kërkoi që memorandumet që janë të rëndësishme të vihen për votim, dhe jo memorandumet e mirëkuptimit që nuk kanë ndonjë rëndësi, propozoi që pika e rendit të ditës për ndërtimin e rrugës “Indrit Cara“ në Vushtrri të largohet nga rendi i ditës.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** – tha se memorandum i mirëkuptimit lidhur me rrugën Stanoc, Breznicë, Kozaricë, Barilevë, Lupç i Poshtëm, është i aprovuar më herët dhe se rruga në fshatin Stanoc, fshat që shtrihet në territorin e Komunës së Vushtrrisë është e përfunduar, andaj Komuna e Vushtrrisë nuk ka ndonjë interes të caktuar për lidhjen e këtij memorandum.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** – tha se është e pakuptimtë që më shumë të kemi pika të futura në rend të ditës në pikën në të ndryshme sesa pika të rregullta, kurse lidhur me këtë ai vlerësoi se kjo po i bie në lajthitje anëtarët e kuvendit se si ata të veprojnë kur është në pyetje për të vendosur për to me anë të votimit. Pastaj ai ceku se në rastet kur kemi grumbullim të pikave në këtë formë ato pika të mos vijnë në mbledhje të rregullt, por për to të thirret një mbledhje e jashtëzakonshme. Në këtë kontekst përsëriti se është krejtësisht pakuptim që katër pika të jenë të rregullta në rend të ditës për të cilat anëtarët e kuvendit janë përgatitur pasi ka ardhur materiali me kohë dhe gjashtë pika në të ndryshme për të cilat nuk ka informacione të bollshme dhe kështu kur kuvendi vendos mund të merr vendime jo të duhura dhe të bëhen gabime.

**Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së** – kërkoi përgjigje nga Zyra ligjore për memorandum në mes katër komunave, ku tha se disa komuna e kanë kaluar në kuvend këtë memorandum, duke pas parasysh se në MAPL-së mund të vlejnjë fonde vetëm pas kalimit të memorandumit në seancë. Po ashtu iu lut që të kenë parasysh interesin e gjithëve edhe të qytetarëve.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** – tha se memorandum është i mirë edhe pse nuk ka informacione se çfarë përfitojmë nga ky memorandum. Por, me një përgjegjësi të plotë tha se rruga që lidh fshatin Stanoc të Epërme me fshatin Breznicë është rruga e asfaltuar dhe më e mira ndoshta në Komunën e Vushtrrisë. Ceku se ajo rrugë është e frekuentuar nga nxënësit që vijnë në mësimet në shkollën fillore “ Migjeni “ ku parashihet që në kuadër të këtij projekti në memorandum të futet edhe çështja e ndërtimit të një trotuari në fshatin Stanoc sepse mund të jetë një shpëtim për jetën e nxënësve që udhëtojnë çdo ditë.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit** - tha nga investimi i ri nga MAPL-ja nga Departamenti për Bashkim Komunal pohon se është një fond që mundëson infrastrukturën përcjellëse. Gjithashtu mendon se do të ishte mirë një bashkëpunim praktik në lidhje për çështjet për ndriçim, zgjerim të rrugëve dhe ndërtime të trotuarit dhe çfarëdo infrastrukture përcjellëse të bëhet.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** - sqaroi memorandum ku tha se ndoshta ka pas edhe ndonjë memorandum tjetër që nuk është respektuar dhe nuk ka ofruar ndonjë të mirë të dukshme. Mirëpo nënshkrimi i një memorandum të tillë në të cilën zotohet edhe Ministria e Infrastrukturës do të përmirësojë infrastrukturën në ç’ rast qytetarët nuk do të humbin vetëm mund të përfitojnë. Gjithashtu edhe mirëmbajtja e rrugës kalon tek kompetenca të ministrisë që sigurisht është një lehtësim për Komunën e Vushtrrisë dhe ndihmesë për qytetarët e asaj zone.

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** – tha se duhet të respektohet Rregullorja e punës e kuvendit, kur flasim për rendin e ditës, dhe shtoi se pika të cilat kanë ardhur në të ndryshme, nuk është se kanë ndonjë urgjencë, dhe kësaj nëse vazhdohet të veprohet kështu, kuvendit po i humb serioziteti për faktin se nëse sjellën më shumë pika të ndryshme se sa pika të rregullta, atëherë kuvendi shpesh po vendos për çështje me rëndësi pa i shoshitur mirë ato çështje dhe kështu po merren vendime shpeshherë jo racionale dhe në kundërshtim me ligjin, ashtu që MAPL-ja këto vendime në disa raste i ka vlerësuar si të kundërligjshme. Në fund ceku dhe shtoi çështjen se a duhet që kuvendi i

komunës të dalë me një qëndrim në nivel të komunës sa i përket kompensimit të orëve mësimore në shkollat e komunës sonë.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** - në arsyetimin e tij për futje në rend të ditës të pikës të ndërtimit të rr. “Indrit Cara” vlerësoi se këtë vit do të bëhet rregullimi i rrugës magjistrale, dhe kjo do të shkaktojë tollovi në trafik, por edhe bajpasat e nevojshëm edhe kjo ndikon në zhbllokimin e rrugës dhe po ashtu aty pari do të hapet një biznes që shpresojmë që do t’i sjellë punësime të reja Komunës së Vushtrrisë pasi si qeveri komunale e kanë përkushtimin që t’i ofrojnë ndihmë bizneseve dhe qytetarëve të komunës.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** – theksoi se komuna e Vushtrrisë është përmendur mjaft për atë parcelë edhe për planin zhvillimor komunal për atë biznes, ku ceku se kryetari i komunës në të kaluarën me opozitë kanë vendosur për mosndërtim, por tha se po përmenden interesat e nënkryetarëve. Mirëpo kryetari është zotu se çdo rrugë që do të shtrohet do të vijë përmes KPF-së.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** – pajtohet me mendimin se secila rrugë që do të shtrohet duhet të kalojë së pari përmes KPF-së pastaj të trajtohet. Por si rast pak më i veçantë iu drejtua kuvendit edhe anëtarëve të KPF-së që janë prezent të kenë pajtueshmëri për shkak të urgjencës që mund të ketë në kuptimin e bajpasave të mundshëm dhe të ketë qarkullim gjatë punës në magjistrale në këtë vit. Në fund si qeverisje bëri thirrje që të mbështesin dhe ceku se kjo nuk e përjashton marrëveshjen që rrugët që duhet të shtrohen të kalojnë përmes KPF-së.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit** – kërkoi nga sekretaria që të komunikojë me Zyrën ligjore dhe zyrën e kryetarit që dinë si po veprojnë tek kjo pikë.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** – ceku se problemi është se tek memorandumit ka qenë tjetër rrugë dhe nuk ekziston memorandum për këtë rrugë. Janë duke e komplikuar në të vërtetë situatën dhe është e thjeshtë sepse sipas tij më së shumti ka nevojë në territorin e Komunës të Obiliqit, të Podujevës sepse janë në gjendje më të keqe. Si përfundim tha se memorandum për rrugën Stanoc, Breznicë dhe Kozaricë nuk ka pas asnjëherë.

***Në fund të diskutimeve jashtë rendit dhe për rendin e ditës, kuvendi pas votimit me 24 vota “për” aprovoi këtë:***

#### **R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 28 shkurt 2019;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja solemne e kuvendit të komunës i datës 6.3.2019;
3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2018;
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2018 në vitin 2019;
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit ndihmës;
6. Shqyrtimi i Planit komunal të veprimit për efikasitet të energjisë;

7. Të ndryshme.

- a). Shqyrtimi i Memorandumit të mirëkuptimit, për rregullimin e rrugës: Stanoc, Breznicë Kozaricë Barilevë Lupç i Poshtëm;
- b). Shqyrtimi i Draft-rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale me Nr. 278/15 e datës 30.12.2015 (**shqyrtimi i dytë**);
- c). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndërtimin e rrugës “Indrit Cara” në Vushtrri;
- ç). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin e vendimit me Nr.53/18, i datës 22.2.2018, për emrimin e anëtarit të Komisionit të Aksonarëve për Ndërmarrjen e mbeturinave “Uniteti”;
- d). Shqyrtimi i kërkesës për ofrimin e ndihmës financiare për Hakif Krasniqin;
- dh). Shqyrtimi i propozimit për shfuqizim të pjesshëm të vendimit të kuvendit me Nr. 22/19 i datës 31.1.2019.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 28 shkurt 2019

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** – paraqiti vërejtjet e tij lidhur me procesverbalin nga mbledhja e kaluar ashtu që në diskutimi i tij të plotësohet se: automjetet zyrtare përveç kryetarit të komunës i cili ka të drejtë 24 orë ta përdorë automjetin zyrtar, të tjerët nuk kanë të drejtë dhe kryetari i komunës duhet të revokojë autorizimin lidhur me këtë çështje për zyrtarët tjerë.

***Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 28.2.2019 me vërejtjen e paraqitura nga anëtari i kuvendit.***

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja solemne e kuvendit të komunës i datës 6.3.2019

**Kushtrim Hyseni, anëtari i kuvendit** - kërkoi të përmirësohet një gabim teknik në procesverbalin e mbledhjes solemne sa i përket emrit të tij.

**Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit** - paraqiti vërejtjet e saj për mosintonimin e himnit kombëtar në mbledhjen solemne të kuvendit për nder të 21 vjetorit të rënies së Komandantit Legjendar Adem Jashari. Gjithashtu kërkoi të bëhet korrigjimi i gabimit teknik sa i përket prezencës dhe mungesave të anëtarëve të kuvendit në mbledhjen solemne.

***Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja solemne e kuvendit, e datës 06.03.2019 me vërejtjet e paraqitura më lartë.***

3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2018

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** – në faqen 2 të raportit për situatën ekonomike financiare për vitin 2018 e përshkruar me bollëk ndër të tjera raportohet se kryetari ka dhënë 32 autorizime, kërkoi që të gjitha këto autorizime të më dorëzohen në kopje fizike. Kam vërejtjet e mia sepse të hyrat vetanake nuk raportohen drejt nëse e analizojmë vitin 2018 realisht dhe shikojmë strukturën e të

hyrave, atëherë vërtet është dashur të ketë rritje figurative të të hyrave sepse nga 1 janari 2018 inkasimi për menaxhimin e mbeturinave me vendim të kuvendit ka kaluar në komunë dhe për raportim të drejtë kryetari është dashtë të pasqyrojë ndaras të hyrat vetanake nga të hyrat për menaxhimin e mbeturinave, të cilat mjete nuk janë të hyra për zhvillimin e projekteve, por e kanë destinacionin e paracaktuar, andaj nëse do raportohet ky fakt, realizimi i të hyrave vetanake do të ishte më i ulët se në vitin 2017. Në vazhdim në faqen 3 thuhet se punëtorët e terrenit të tatimit në pronë, gjatë vitit 2018 kanë evidentuar 9364 prona të paluajtshme, prej tyre 2002 regjistrime të reja pastaj 6249 verifikime dhe 1.113 përmirësime sa i përket sipërfaqes së cilësisë, por askund nuk thuhet e që është obligim ligjor se sa prona banesa, shtëpi e objekte afariste u janë nënshtruar llogaritjes së amortizimit dhe kjo është shqetësuese dhe për korrektësi po theksoj se kjo gjendje vazhdon me vite të tëra dhe qytetarëve u merret tatimi në pronë më shumë se sa që saktëson baza ligjore e vlerësimit. Unë në këtë rast po kërkoj që të ndërmerren veprimet e domosdoshme në mënyrë që të plotësohet kërkesa ligjore dhe qytetarët të mos paguajnë më shumë se sa që është detyrimi ligjor. Sa i përket buxhetit të planifikuar dhe shpenzimeve, kjo qeveri te investimet kapitale nuk ka pasur kapacitetin e duhur të menaxhimit dhe në saje të kësaj performance të dobët qytetarët janë dëmtuar ose kanë marrë shërbime e projekte në shërbim të tyre më pak për fiks 1.096.396,14 €, si dhe këto mjete pjesa dërrmuese kanë shkuar në suficit në buxhetin e Republikës së Kosovës. Në total kjo qeveri ka realizuar buxhetin më pak se sa që kishin planifikuar me buxhet fiks 1.763.511,00 € dhe fiks për këtë vlerë qytetarët e Vushtrisë janë të dëmtuar sepse nuk kanë marrë projektet e buxhetuara për ta. Mandej ai ceku se indikator shqetësues është edhe moskonkurrenca në sistemin dhe procedurat e prokurimit, ku kemi pasur mjaft shumë aktivitet kontraktues përmes negocimit në shuma të larta financiare e që kjo rrit mundësinë për aktivitet korruptiv dhe për dyshime tjera për siç tha ai duke iu referuar zhargonit popullor (ka pasur goditje të çmimit të punëve) e që kjo lë hapësirë për dyshime. Përkundër kësaj ai është në dijeni se procedura e negocimit të punëve është mekanizëm i ligjshëm, porse ai ndodh vetëm në raste specifike dhe gjithëherë. Pastaj procedurat e kuotimit të çmimit gjithashtu nuk janë procedura të pëlqyeshme pasi që këto ndikojnë në shpenzimin enorm të buxhetit. Procedura për kontrata në vlerë minimale nuk është në rregull pasi që në këto dy pozicione kemi rreth 200,000.00 € për të cilat ai shpreh dyshimet e tij për siç tha keqpërdorim. Andaj konform këtyre ai apeloj që t'i shmangemi procedurave të negocimit atyre të koutimit dhe kontratave me vlerë minimale, pasi që këto ngërthejnë në vete çmim të lartë të kontraktimit të shërbimeve dhe karakterizohen nga jotransparenca.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** – duke iu referuar faqes 6 të raportit "servisimi dhe mbushja e aparateve kundër zjarrit" ku nuk ka pasur kërkesë për inicim të aktivitetit, dhe për këtë pyeti se këto aparate ku janë mbushur apo ripërtërirë pasi afati i sakdencës së tyre është 6 muaj. Pastaj shërbimet e deratizimit, dezinfektimit dhe dezinfektimit, ku në raport shkruan se këto shërbime janë realizuar, në këtë kontekst njoftoi se bazuar në udhëzimin administrativ përcaktohet se gjatë muajit gusht duhet të bëhet deratizimi, dezinfektimi dhe dezinfektimi i shkollave fillore dhe të mesme por shtoi se ky aktivitet vitin e kaluar nuk është kryer. Ai nuk është në dijeni që ky aktivitet është kryer në vitet e kaluara, porse një aktivitet i tillë është obligim që del nga udhëzimi administrativ në ç'rast drejtoritë komunale të arsimit duhet ta realizojnë këtë aktivitet. *Pastaj kërkoi përgjigje me shkrim nga Drejtoria kompetente e Urbanizmit lidhur me asfaltimin e rrugës që lidh fshatrat Stanoc-Lumadh-Prelluzhë-Gracë projekt dyvjeçar, në këtë kontekst duhet të sqarohet se ku ndodhet kjo rrugë, a ka filluar, a është realizuar ky projekt dhe nëse po sa është kostoja e këtij projekti.* Pastaj tek faqja 26 e raportit që lidhet me fushën e arsimit, ku ceku se e shqetëson fakti i mungesave të shumta në arsimin e mesëm të ulët dhe atë të mesëm të lartë. Pastaj

ai duke aplikuar metodën e krahasimit statistikor të numrit të nxënësve ceku se në fillim të vitit shkollor 2018/2019 krahasuar me vitin shkollor 2017/2018 numri i nxënësve në nivelin parafillor në vitin 2017 është 1003 nxënës, kurse në vitin 2018 1062 nxënës ndërsa, raporti është -59, ndërkaq krahasimi duhet të jetë +59 për faktin se në vitin 2018 kemi 59 nxënës më shumë se sa në vitin 2017. Pastaj tek niveli 1 në vitin 2017 kemi 5435 nxënës, kurse në vitin 2018 kemi 5407, krahasimi është 28 e që duhet të jetë -28 për faktin se në vitin 2018 i kemi 28 nxënës më pak, e njëjta vlen edhe për nivelin 2 dhe 3 ku kemi 292 nxënës më pak nëse i krahasojmë. Tutje tek suksezi i nxënësve në nivelin fillor ku kemi 5356 nxënës me sukses pozitiv ose 99.25 %, nuk ceket numri i përgjithshëm i nxënësve, me sukses të pamjaftueshëm i kemi 35 nxënës, ndërsa 5 nxënës janë të panotuar, dhe nëse i numërojmë këta del se në nivelin fillor janë 5396 nxënës dhe nëse krahasohet me raportin që është sjellë këtu del se në nivelin fillor kemi 5407, ndërsa është raportuar se kemi 5356 që i bie se kemi 11 nxënës më pak, d.m.th kemi pasaktësi në raportim. Mandej në faqen 27 të raportit suksezi i nxënësve në nivelin e mesëm të ulët ku kemi 4446 me sukses pozitiv apo 72.62 %, mirëpo bazuar në këtë përqindje i bie se me sukses pozitiv janë 3229 nxënës, me sukses të pamjaftueshëm thuhet se janë 27.01, por nuk ceket numri i nxënësve, por që i bie 1201 nxënës, kurse 16 nxënës janë të panotuar. Nëse krahasojmë vitin shkollor nga perioda e parë në muajin shtator e deri në muajin dhjetor kemi 77 nxënës më pak, nëse ia shtojmë edhe 11 nxënës tjerë kemi gjithsej 88 nxënës. Tek suksezi i nivelit të mesëm të lartë ku kemi 3146 nxënës prej tyre 1379 me sukses pozitiv apo 43.83%, me sukses të pamjaftueshëm janë 55.97% por këtu nuk ceket numri i nxënësve e që do të duhej të evidentohet, por sipas llogaritjes i bie se janë 1761 nxënës me sukses të pamjaftueshëm, si dhe 6 nxënës janë të panotuar. Nëse bëjmë krahasim me tabelat që janë një faqe më përpara, del se në nivelin e mesëm të lartë për periudhën 4 mujore kemi 269 nxënës më pak. Në bazë të kësaj del se nga data 3 shtator e deri në fund të muajit dhjetor 2018 kemi -357 nxënës që nuk përputhen në statistika, kjo është shumë shqetësuese për faktin se ku gjenden këta nxënës. Pastaj nëse e krahasojmë numrin e nxënësve të vitit 2017 me vitin 2018, del se në vitin 2018 i kemi 708 nxënës më pak. Konform kësaj del konstatimi se nëse 357 nxënës për një periode janë më pak, ndërsa 708 nxënës më pak krahasuar me vitet 2017/2018, kjo është shumë shqetësuese sepse kemi një shkollë fillore mesatare më pak në aspektin e numrit të nxënësve. Lidhur me këto të gjetura të apostrofuara më lartë kërkoi nga Drejtoria e Arsimit që raporte të tilla mos të sillen në kuvend, rekomandoi që të përmirësohen, duke shtuar një rubrikë ku do të evidentohet se këta nxënës a e kanë braktisur shkollën që kanë mbetur të panotuar apo kanë emigruar jashtë shtetit. Në fund tha se ju informoj se afër 100 nxënës që kryejnë klasën e IX regjistrohen në shkollën e mesme qoftë në Mitrovicë apo Prishtinë, kryesisht në drejtimet e mjekësisë, andaj duke pasur parasysh se dita ditës po zvogëlohet numri i nxënësve, propozoi që në shkollat tona të hapet një paralele me drejtime të mjekësisë pasi ata nxënës mund të bëjnë praktikën në komunën tonë në institucionet shëndetësore.

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** – përsëriti kërkesën e tij për informatë se si është e mundur që një rrugë me kubëza në gjatësi prej 170 m ka kushtuar 10800 €, kurse një rrugë me gjatësi prej 200 m ka kushtuar 4800 €, për këtë kërkoi që të bëhen korrigjime nëse bëhet fjalë për gabime teknike, por nëse kjo është ashtu siç është publikuar, atëherë është shumë shqetësuese.

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** – tha se nuk është vendi këtu për të treguar statistika lidhur me raportin sepse Drejtoria e Arsimit i paraqet brenda vitit edhe katër raporte të tjera. Por sipas tij arsimit është futur gabimisht sepse ka të dhëna statistike që nuk lidhen me bazë ekonomike d.m.th ky raport sipas tij duhet të përmbajë se sa realizohen projektet financiare dhe sa kushton transporti i nxënësve me një fjalë sa janë mjetet që janë shpenzuar për infrastrukturë në lidhje me furnizim të shkollave me pajisje adekuate. Po ashtu theksoi se tek kultura se nuk është me rëndësi



se sa ka libra e gjëra të tjera, me rëndësi është kostoja se sa janë sjell në këtë vit libra dhe sa kanë kushtuar.

**Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së** - paraqiti sqarime lidhur me raportin për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2018, duke u përgjigjur në pyetjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

***Pas përfundimit të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi në mënyrë “unanime” aprovoi Raportin për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2018.***

**4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2018 në vitin 2019**

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake nga viti 2018 në vitin 2019 në kategoritë si në vijim:**

<b>1.1 Paga dhe mëditje .....</b>	<b>34,089.16 €</b>
<b>1.2 Mallra dhe shërbime .....</b>	<b>278,883.55 €</b>
<b>1.3 Shpenzime komunale.....</b>	<b>12,404.71 €</b>
<b>1.4 Subvencione dhe transfere.....</b>	<b>2.737.00 €</b>
<b>1.5 Investime kapitale .....</b>	<b>707,413.94 €</b>
<b>Totali i mjeteve të bartura .....</b>	<b>1,035,528.36 €.</b>

**2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.**

**3.Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operationale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.**

**4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë**

**5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit ndihmës**

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit** – tha se ekziston droja që këtë vendim nuk do ta pranojë MAPL-ja pasi që prona e caktuar si lokacion për ndërtimin e këtij stadiumi ndodhet në pronat që bëjnë pjesë si tokë bujqësore nën komasacion. Andaj për këtë ai kërkoi që të kemi një pronë të evidentuar si rezervë për këtë qëllim.

**Ilmi Azemi , anëtar i kuvendit** – tha se grupi kuvendar i PDK-së e mbështet këtë propozim-vendim për ndërtimin e këtij stadiumi, për faktin se kjo ka qenë ide e qeverisjes së kaluar, dhe se kjo është në interes të qytetarëve.

**Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit** – tha se për këtë projekt duhet të merret për bazë mendimi i klubeve të futbollit, dhe shtoi se më i përshtatshëm kishte me qenë lokacioni në fshatin Maxhunaj, pasi që në një parcelë është bërë përgatitja e terrenit për ndërtimin e një stadiumi nga ana e KFOR-it, dhe ky lokalitet do të ishte më i përshtatshëm për ngritjen e këtij stadiumi.

**Adnan Lahu , drejtor i DGJKP-së** – paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke u përgjigjur në çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit. Ai më tutje njoftoi se ka edhe prona tjera ku do të mund të ndërtohej ndonjë stadium, dhe për këtë drejtorja i posedon shënimet lidhur me këto prona. Ai sqaroi se edhe në ndonjë lokalitet tjetër do të shikohet mundësia për ndërtimin e ndonjë stadiumi.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e Stadiumit ndihmës të futbollit në parcelën kadastrale P-70202024-00227K-0, në sipërfaqe prej 53250 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Dobërllukë, pronë e Komunës së Vushtrrisë.**

**2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, si dhe Drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.**

**3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit**

**4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**6. Shqyrtimi i Planit komunal të veprimit për efijencë të energjisë**

**Nezir Klinaku anëtar i kuvendit** - theksoi se e ka përmendur edhe herëve të tjera se plani i komunës për efijencë të energjisë është i kopjuar dhe të dhënat për shpenzimin e energjisë në objektet komunale mungojnë prandaj edhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik shumë objekte i ka hequr nga trajtimi dhe kërkoi prapë të largohet ndërtesa e kadastrit për shkak se ajo ndërtesë veçse është në rinovim e sipër dhe nuk ka kuptim ta kemi prioritet Drejtorinë e Kadastrit nga fondi për efijencë prandaj kërkoi që të vendoset ndonjë objekt tjetër në prioritet dhe të largohet ai objekt, kurse kjo ka qenë ajo që e ka thënë edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, mirëpo e tëra që ishte rregulluar në planin e veprimit ishte aspekti drejtshkrimor dhe korrigjimi i emrit të qytetit nga Skënderaj në Vushtri. Në fund e ritheksoi kërkesën e tij për largimin e Drejtorisë së Kadastrit dhe të futet ndonjë shkollë ose ndonjë objekt tjetër.

**Nasuf Aliu kryesues i kuvendit** – e falënderoi anëtarin e kuvendit z. Klinakun edhe për kontributin e tij edhe në KPF rreth kësaj çështjeje dhe shpeshoi që drejtoritë përkatëse t’i marrin këto vërejtje dhe ta modifikojnë këtë plan sipas rrethanave që tashmë jemi.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

**1.Me këtë vendim jepet në diskutim publik Draft-Plani i Veprimit për Eficiencë të Energjisë 2019-2021.**

**2.Diskutimi publik fillon nga data 8 prill 2019 dhe zgjat deri më 8 maj 2019.**

**3.Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013.**

**4.Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike që si propozues i draft-planit në fjalë, të organizojë diskutimin publik konform Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.4.2013. Gjithashtu obligohet drejtoria e sipërcekur që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantojë Kuvendit të komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të draft-planit në fjalë, në mbledhjen e kuvendit në muajin maj 2019.**

**5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

7.Të ndryshme.

a). Shqyrtimi i Memorandumit të Mirëkuptimit, për rregullimin e rrugës: Stanoc, Breznicë Kozaricë Barilevë Lupç i Poshtëm

**Ymer Haradinaj anëtar i kuvendit** – në fjalën e tij rreth këtij memorandumit kërkoi përfshirjen e lagjes “Dalip Maloku” (ish ushtar i UÇK-së) dhe theksoi se kjo rrugë është rreth 2 km, si dhe ceku se rruga është shumë e mirë mirëpo ka mungesë të kanalizimit dhe si pasojë e kësaj rrezikohet të përhapet ndonjë epidemi e sidomos për fëmijët, të cilët frekuentojnë andaj për të shkuar në shkollë kjo është mjaft me rëndësi, por me rëndësi është edhe vazhdimi i ndriçimit të pjesës tjetër për shkak se një pjesë është ndriçuar me ndihmën e tij në bashkëpunim me Kreditimin Rural të Kosovës, por kishte me qenë mirë të ndërtohet edhe trotuari në këtë rrugë për shkak se do të përfshiheshin disa lagje.

**Nezir Klinaku anëtar i kuvendit** - parashtrioi pyetje se a e kanë nënshkruar kryetarët e komunave të përfshira në këtë memorandum, ai i Obiliqit, Vushtrrisë, Prishtinës dhe Podujevës?

Pyetja tjetër nga z. Klinaku ishte se pse të gjithë mbiemrat e kryetarëve tjerë në këtë memorandum janë të shënuar me të vogla përveç atij të Xhafer Tahirit?

**Nasuf Aliu kryesues i kuvendit** – rreth pyetjes së parë se z. Klinakut i sqaroi se nga ministria është kërkuar se pari të nxjerrin vendim se kanë vullnet për këtë bashkëpunim pastaj të përcillet në ministri për vlefshmëri, pastaj hap i radhës do të jetë nënshkrimi i marrëveshjes nga kryetarët dhe kjo marrëveshje do të kthehet prapë në ministri do të thotë se ende nuk është nënshkruar.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim aprovet Memorandumi i mirëkuptimit mes Komunës së Vushtrrisë, Komunës së Obiliqit, Komunës së Prishtinës dhe Komunës së Podujevës.**

**2. Qëllimi i këtij Memorandumi të mirëkuptimit është rregullimi i rrugës Stanoc, Breznicë, Kozaricë, Barilevë Lupç i Poshtëm, në gjatësi prej 14 km e që shtrihet në territorin e komunave të përfshira në këtë memorandum të mirëkuptimit.**

**3. Autorizohet Kryetari i komunës që t’i ndërmarrë veprimet e nevojshme me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit, si dhe t’i marrë përsipër obligimet që burojnë nga ky dokument me qëllim të implementimit të këtij memorandum të mirëkuptimit.**

**4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Kryetari i komunës dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.**

**5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**b). Shqyrtimi i Draft-rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale me Nr. 278/15 e datës 30.12.2015 (shqyrtimi i dytë)**

**Ilmi Azemi anëtar i kuvendit** - në lidhje me propozimin për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për tarifa dhe ngarkesa komunale me Nr.278/15 30.12.2015 konsideroj se ndryshimi në formën e propozuar është jokonform ligjit, konfuz dhe si i këtillë vështirë i aplikueshëm sepse thirrja në udhëzimin administrativ për caktimin për taksën rreth lejes ndërtimore dhe leje-rrënimi me këtë propozim vendim dhe duke u bazuar në udhëzimin administrativ 06/2017 të propozuar dhe të miratuar nga ministria MMPH nuk janë të përcaktuara metodat për taksën ndërtimore për asnjë kategori ndërtimi, prandaj ky propozim-vendim është në kundërshtim të plotë me udhëzimet juridike të përcaktuara në udhëzimin administrativ Nr. 02/2018, ku në këtë udhëzues administrativ në kapitullin 2 taksa administrative për leje ndërtimore, neni 4 saktëson se si bëhet llogaritja e taksës administrative për leje ndërtimore të kategorisë së parë dhe kategorisë së dytë të ndërtimit, neni 5 po i udhëzimi administrativ saktëson se si bëhet vlerësimi i taksës administrative për kategorinë e parë dhe të dytë të lejes së ndërtimit, kurse neni 6 i këtij udhëzimi rregullon taksën administrative për kategorinë e tretë të ndërtimit, neni 12 i udhëzimit rregullon këto çështje për kategorinë e 3 të ndërtimit, neni 12 rregullon llogaritjen, caktimin dhe vlefshmërinë për taksën për leje rrënimi, për kategorinë e parë dhe kategorinë e dytë, kurse neni 13 rregullon kategorinë e 3 të ndërtimit. Neni 14 rregullon dhe udhëzon mënyrën e miratimit dhe publikimit të taksave dhe tarifave për kategorinë e parë dhe të dytë të ndërtimit, ndërsa neni 15 rregullon po të njëjtën çështje për kategorinë e ndërtimit. Nga faqja 28 e këtij udhëzimi administrativ jepen në formë tabelare metodologjia e llogaritjes së taksës administrative me sqarime adekuate, po ashtu edhe metodologjia e taksës për leje ndërtimi me tabela kalkulative, pra të gjitha janë të sqaruara me shembuj. Pra mbetet nga drejtoria vetëm të vendosë logon e Komunës së Vushtrrisë dhe ta zbatojë

në përpikëri këtë udhëzim administrativ. Ai theksoi se nga të gjitha ato që ka përmendur, propozimi nuk e përmbush kriterin ligjor për t'u aprovuar në këtë mbledhje. Prandaj si grup parlamentar në këtë formë që është propozuar do të votojnë kundër dhe do të kërkojmë që i njëjti të plotësohet pasi vetëm ashtu do të jetë ligjor.

**Agron Përçuku anëtar i kuvendit** – theksoi se ka vërejtje tek kjo rregullore, kur bëhet fjalë tek neni 2 dhe në bazë të kësaj rregulloreje bëhet përcaktimi i taksave dhe tarifave të obliguesit, procedura e pagesave dhe mënyra e llogaritjes për:

- A) Taksat administrative dhe shenjën e lejes së ndërtimit.
- B) Tarifa për rregulluesit për rritjen e densitetit të infrastrukturës.

Vërejtje ai kishte tek pika B se deri në çfarë mase mund të shkojë tarifa rregulluese për rritjen e densitetit të infrastrukturës, kurse propozoi të ceket se duhet të jepet me një shumë më së paku deri në 5%.

**Ilijana Azemi, përfaqësuese e Drejtorisë për Urbanizëm** - tha se sa i përket draftit të plotësim-ndryshimit të Rregullores për tarifa komunale me Nr. 278/15 të datës 30.12.2015 theksoi rreth pyetjes së parë që ishte se nuk ka bazë ligjore. Ajo theksoi se nuk pajtohet sepse Udhëzimi administrativ 06/2017 është udhëzim që parasheh parallogaritjen në këtë formë dhe taksa është llogaritur bruto dhe tani duhet të llogaritet neto, pastaj janë të cekura dhe llogaritja e tarifës se si duhet të bëhet koeficienti, sipërfaqja neto e banesës, sipërfaqja e hapësirës përkatëse në banesë dhe ato që tha anëtari i kuvendit z. Ilmiu se nuk janë të cekura në udhëzimin administrativ janë te shtojcat dhe janë pjesë e udhëzimit administrativ, si dhe na obligojnë t'i zbatojmë. Ne si drejtori jemi të obliguar ta zbatojmë udhëzimin administrativ dhe e kemi zbatuar edhe para se ta sjellim këtë draft-rregullore, mirëpo në bashkëpunim me auditorët e jashtëm, të cilët kanë kërkuar që të harmonizohet rregullorja e brendshme komunale, komform akteve tjera siç janë udhëzimi administrativ dhe ligjet tjera dhe kur të vijnë në auditim viteve të tjera të merren vetëm me rregulloren e brendshme dhe jo me tërë legjislacionin. Pika tjetër që kemi bërë në udhëzimin administrativ është që u kemi lehtësuar bizneseve që taksën mund ta bëjnë me këste, kështu që me këtë veprim kemi menduar 'ti nxisim investitorët të aplikojnë për leje ndërtimi, ndërsa sa i përket pyetjes së dytë se nuk i ka të qarta taksat për leje ndërtimore sqaroi se këto janë taksa të parapara në udhëzimin administrativ që na obligojnë t'i marrim ata parametra për të llogaritur taksën për leje ndërtimi. Për ta harmonizuar udhëzimin administrativ dhe rregulloren e brendshme na nevojitet miratimi juaj dhe në shtator të fillojmë me dëgjime publike dhe pastaj ta dërgojmë në ministri për aprovim, pastaj të fillojmë nga janari i vitit të ardhshëm me zbatim. Pra rregullorja duhet të harmonizohet me udhëzimet dhe ligjet në fuqi.

*Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit në mënyrë "unanime" aprovoi Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale me Nr. 278/15 e datës 30.12.2015.*

c). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndërtimin e rrugës "Indrit Cara" në Vushtrri

**Ilmi Azemi anëtar i kuvendit** - theksoi se parimisht është për çdo rrugë që do të ndërtohet dhe lehtësojë jetën e qytetarëve, mirëpo në këtë propozim-vendim në pikën 1 thuhet se lejohet ndërtimi i rrugës "Indrit Cara" me asfalt në gjatësi 250 m dhe mjetet do të sigurohen nga investimet kapitale në Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Këtu hasim në një kontradiktë sepse mjetet e drejtorisë nuk

kanë të bëjnë me asfaltim të rrugëve, kurse pyetja është a e keni paraparë koston financiare sepse në propozim -vendim nuk ceket se si do të barten mjetet tek Drejtoria e Shërbimeve Publike. Pyetja tjetër ishte se Drejtoria për Financa nuk e ka bërë paramasën ose paralogarinë e këtij projekti dhe nuk është në rregull që të votohet ky projekt pa e ditur vlerën, si dhe nuk është e qartë se si do të financohet dhe cili projekt do të hiqet pasi drejtoria nuk ka buxhet rezervë. Tutje tha se këtu kemi edhe përzierje të kompetencave për shkak se Drejtoria e Shërbimeve Publike nuk është kompetente për asfaltim të rrugëve.

**Refik Maloku, drejtor i Drejtorisë së Shërbime Publike** - sqaroi se është nga fondi për bashkëfinancim dhe sa i përket procedurave do të shkohet me tenderim.

**Ilmi Azemi anëtar i kuvendit** – shprehu se nuk është sjell si bashkëfinancim dhe nuk është cekur askund se është bashkëfinancim dhe si i tillë propozimi që është sjell ka mundësi të refuzohet nga ministria

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** - kërkoi mirëkuptim nga të gjithë që ta përkrahin këtë projekt edhe pse ndoshta nuk është sjell në formën më të mirë të mundshme dhe kërkoi ta mirëkuptojnë drejtorinë për shkak se është vetëm në ditën e dytë të punës dhe i mori për bazë shqetësimet që u shprehen nga anëtari i kuvendit.

**Faton Shabani, anëtar i kuvendit** - kërkoi nga drejtoria që krahas rregullimeve tjera t'i rregullojnë edhe gabimet në drejtshkrim p.sh diku thuhet rr."Endrit Cara" diku rr."Indrit Cara"

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 31 vota "për" 1 votë "abstenim" vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim lejohet ndërtimi i rrugës „Indrit Cara” (me asfalt) në Vushtrri, në gjatësi L=215 [m], kurse mjetet financiare do të sigurohen nga investimet kapitale - Fondi për rikonstruim të rrugëve në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.**

**2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shërbime Publike.**

**3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

ç). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin e vendimit me Nr.53/18 i datës 22.2.2018, për emërimin e anëtarit të Komisionit të Aksonarëve për Ndërmarrjen e Mbeturinave "Uniteti"

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës** - falënderoi ish-drejtorin Sadat Rashicën për punën e tij si drejtor dhe shtoi se e kupton se gjatë aktivitetit politik mund të ketë mosmarrëveshje, dhe diskrepanca, por e vërteta është se ish-drejtori Rashica, ka qenë drejtor i suksesshëm dhe që ka punuar për interes të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë "unanime" vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01Nr.53/18 i datës 22.2.2018 për emërimin e anëtarit të Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Rajonale të Mbeturinave „Uniteti” Sh. A. Mitrovicë, për Komunën e Vushtrrisë, ashtu që në vend të z. Sedat Rashica, emërohet z. Refik Maloku i cili aktualisht është drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike.**

**2. Komisioni Komunal i Aksionarëve, kompetencat dhe përgjegjësitë e tij i ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Ligjit për Shoqëritë Tregtare, si dhe akteve tjera juridike në fuqi me të cilat është rregulluar kjo çështje.**

**3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Shërbime Publike.**

**4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**d). Shqyrtimi i kërkesës për ofrimin e ndihmës financiare për Hakif Krasniqin**

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit** - sqaroi se në bashkëpunim me Zyrën ligjore dhe sekretarinë, bazuar në rregulloret që ka komuna, e tëra çfarë mund të bëjmë është të nxjerrim një rekomandim dhe t’ia dërgojmë kryetarit të komunës dhe departamentit përkatës për mbështetje financiare.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** - shprehu se kryetari i komunës ka të drejtë të ndajë mjetet financiare deri në vlerë një mijë (1000) euro, të shpërndajë mjete pa aprovim të kuvendit në raste të dëmeve nga fatkeqësitë në rolin e subvencioneve, kurse kuvendi i komunës ka autoritetin të merr vendime të pakufizuara duke pas parasysh mundësitë buxhetore dhe kërkoi të ndihmohet ky fermer me dy mijë euro (2000 €).

**Bahrije Ademi-Murati, anëtare e kuvendit** - kërkoi që së pari dëmet të vlerësohen nga një komision i caktuar pastaj të ndahen mjetet.

**Qerimi Selimi, anëtar i kuvendit** - kërkoi që të nxjerrët një rekomandim nga kuvendi për kryetarin e komunës dhe drejtoritë përkatëse dhe ata të sjellin një propozim.

**Albanez Tahiraj, zyrtar i lartë ligjor** - sqaroi se kuvendi i ndalohet të ndajë mjete me rregulloren aktuale, kuvendi subvencionet i miraton njëherë në vit. Kuvendi asnjë cent nuk i lejohet të ndajë për raste individuale. Mandej shtoi se nëse kuvendi e sheh të arsyeshme, atëherë mund të procedojë ndryshimin e Rregullores për subvencione.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:**

**Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë 28 mars 2019, pas shqyrtimit të propozimit të anëtares së kuvendit znj. Fatmire Saraçi për ofrimin e ndihmës financiare për Hakif Krasniqin të cilit nga një zjarr aksidental i është djegur shtalla, Kryetarit të komunës i parashtron këtë:**

## REKOMANDIM

**Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë i rekomandon Kryetarit të komunës, që të sipërcekurit t'i ndajë mjete financiare konform mundësive financiare dhe ligjore.**

## ARSYETIM

**z. Hakif Krasniqi nga fshati Gllavatin Komuna e Vushtrrisë, ka njoftuar se pas një zjarri aksidental, i është djegur në tërësi shtalla e bagëtive, në ç' rast i janë shkaktuar dëme të mëdha materiale, andaj kërkon nga komuna që t'i ofrojë ndihmë financiare që sado pak ta sanojë këtë gjendje.**

*Rekomandohet që Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, t'i zhvillojnë procedurat e akordimit të kësaj ndihme financiare konform legjislacionit në fuqi.*

**dh).** Shqyrtimi i propozimit për shfuqizim të pjeshëm të vendimit të kuvendit me Nr. 22/19 i datës 31.1.2019.

**Ilmi Azemi anëtar i kuvendit** - në emër të grupit kuvendar përkrahi idenë që komuna të intervenojë në gjetjen e një zgjidhjeje për banorët që jetojnë në objektin banesor i cili më herët ishte dhënë në shfrytëzim, po ashtu ai tha se vendimin në fjalë grupi i tyre e kishte mbështetur me qëllimin më të mirë në gjetjen e një zgjidhjeje për banorët, por nëse kuvendi e sheh të arsyeshme ndryshimin e këtij vendimi, atëherë grupi kuvendar i PDK-së do ta përkrah këtë propozim.

**Adnan Lahu, drejtori i DGJKP** – sqaroi se në mbledhjen e janarit në kuvend është sjell një propozim-vendim për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale, njëri ka qenë për shfrytëzim afatgjatë dhe njëri për shfrytëzim afatshkurtër, kurse në mesin e këtyre propozimeve ka qenë edhe kjo parcela për shfrytëzim afatgjatë, pra kjo parcelë është votuar në janar që të jepet në shfrytëzim pas kërkesës së banorëve, të cilët janë pajtuar edhe me një deklaratë te noteri se nëse komuna ka mundësi të ndërhyjë i lejohet.

**Nezir Klinaku anëtar i kuvendit** - kërkoj nga Zyra ligjore interpretim për vendimin e janarit për atë parcelë, pasi mendon se në mbledhjen kur ishte votuar ai vendim për atë ndërtesë banuese kolektive ishte sjell në lajthitje MAPL-ja, dhe në këtë rast duhet të sqarohet se a ka drejt kuvendi të aprovojë një vendim të tillë kur dihet fakti se në atë parcelë ndodhet një objekt kolektiv në bashkëpronësi.

**Qerimi Selimi anëtar i kuvendit** - përkrah propozimin për intervenim në atë ndërtesë dhe të ndryshohet vendimi i janarit.

**Ilmi Azemi anëtar i kuvendit** - tha se parimisht ata e mbështesin propozimin që atyre banorëve t'ju bëhet një zgjidhje, qoftë edhe përmes renovimit të atij objekti, pasi qëndrueshmëria e statike e atij objekti është e mirë dhe njoftoi se si grup politik e përkrahin propozimin që kjo pronë t'i kthehet komunës.

**Albanez Tahiraj, zyrtar i lartë ligjor** - në përgjigjen e tij para anëtarëve të kuvendit, sqaroi se në këtë fazë kjo çështje juridike është e konsumuar pasi vendimi për këtë çështje është konfirmuar si i ligjshëm nga ana e MAPL-së dhe se tani jemi në faza tjera të implementimit të këtij vendimi. Mirëpo pavarësisht kësaj kuvendi ka të drejtën që të vendosë në mënyrë tjetër duke e ndryshuar



këtë vendim. Si Zyrë ligjore e komunës nuk kanë kompetencë që të interferojnë në vlerësimet që i jap MAPL-ja.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim shfuqizohet pika 1.2 e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01 Nr.22/19 i datës 31.1.2019, që ka të bëjë me parcelën kadastrale P-7020216-02356-1 në sipërfaqe prej 1058 m<sup>2</sup>.


2. Me vendim paraprak me Nr.22/19 ishte dhënë në shfrytëzim prona e cekur në pikën 1 të këtij vendimi në periudhë afatgjate prej 99 viteve, tani kuvendi vendos që kjo pronë të mbetet në pronësi komunale për interes të përgjithshëm.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në ora 13:15.

Bastri Duraku



---

Procesmbajtës

Nasuf Aliu



---

Kryesues i Kuvendit